

V E N D I M
Nr.275, datë 12.6.1993

**PËR MBËSHTETJEN E PËRKOHSHME FINANCIARE NGA SHTETI TË FAMILJEVE TË
PUNONJËSVE TË NB-VË QË PRIVATIZOHEN SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NR.428, DATË 5.10.1992**

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale e të Përndjekurve Politikë dhe të Ministrisë së Financave e të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Familjet e punonjësve të NB-ve që privatizohen, për periudhën 1 korrik 1993 gjer më 30 shtator 1993, mbështeten financiarisht si më poshtë:

a) Kur ka marrë tokë gjer më 31 dhjetor 1992, i jepet mbështetje financiare diferenca e të ardhurave për frymë deri në 300 lekë në muaj.

b) Kur ka marrë tokë gjer më 31 mars 1993, i jepet mbështetje financiare diferenca e të ardhurave për frymë deri në 400 lekë.

c) Kur ka marrë tokë gjer më 31 maj 1993, i jepet mbështetje financiare diferenca e të ardhurave për frymë deri në 500 lekë në muaj.

ç) Kur ka marrë tokë pas datës 31 maj 1993, i jepet mbështetje financiare diferenca e të ardhurave për frymë deri në 600 lekë në muaj.

2. Familjeve të punonjësve të NB-ve që privatizohen, për periudhën 1 tetor 1993 gjer në 31 dhjetor 1993, i jepet mbështetje financiare 70 për qind e masës së caktuar në pikën 1, shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç".

3. Në të ardhurat për frymë, për efekt të llogaritjes së mbështetjes financiare, përfshihen të ardhurat nga puna në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, pensionet, përkrahja sociale, ndihmat dhe bursat, si dhe kompensimet e shpenzimeve nga ngritja e çmimeve. Përfshihen të ardhurat që realizohen nga aktiviteti në sektorin e bujqësisë.

4. Nuk e përfitojnë këtë mbështetje financiare familjet që refuzojnë të marrin tokë në përdorim ose pronësi.

5. Mbështetja financiare llogaritet në bazë të të dhënave të deklaratës, sipas modelit të bashkëlidhur.

Personi që nuk deklaron të vërtetën ose nuk njofton brenda 15 ditëve për çdo ndryshim të deklaratës, detyrohet të kthejë 20 fishin e mbështetjes financiare që ka përfituar padrejtësisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund t'i bëhet. Urdhri lëshohet nga kryetari i komunës ose i bashkisë dhe është titull ekzekutiv.

6. Mbështetja financiare bëhet në komunë ose bashki.

7. Efektet financiare prej 340 milionë lekësh përballohen nga Buxheti i Shtetit. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, brenda datës 20 qershor 1993, të paraqesë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë detajimin e këtij fondi për çdo komunë ose bashki.

8. Për familjet fshatare të ish-kooperativave bujqësore me sipërfaqe të kufizuar toke dhe të ardhura të pakta rritet masa e përkrahjes ekonomike, si efekt i rritjes së çmimit të shitjes së grurit me 203 lekë në muaj për frymë.

9. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.428, datë 5.10.1992 "Për kriteret e dhënies së përkrahjes ekonomike familjeve fshatare me sipërfaqe të kufizuar toke dhe të ardhura të pakta", ndryshuar me vendimin nr.110, datë 6.3.1993, ndryshohet pasqyra nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi, e cila zbatohet nga 1 korriku 1993 gjer më 31 dhjetor 1993. Efektet financiare prej 207 milionë lekësh përballohen nga Buxheti i Shtetit.

10. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit ngarkohet për shumëfishimin e deklaratës dhe lëshimin e udhëzimeve përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet financiare zbatohen nga data 1 korrik 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

MASA E PËRKRAHJES EKONOMIKE PËR FAMILJET FSHATARE ME
SIPËRFAQE TOKE TË KUFIZUAR DHE TË ARDHURA TË PAKTA

Sipërfaqe m² për frymë

Pjelloria e tokës sipas klasifikimit

Grupi\Grupi\Grupi\Grupi\Grupi

I-II\III-IV\ V \VI-VII\VIII-X

1. 0-250 m ²	313	333	353	368	453
2. 251-500m ²	293	308	328	343	403
3. 501-750 m ²	263	283	293	323	353
4. 751-1000 m ²	243	263	283	298	313
5. 1001-1250 m ²	223	238	253	273	293
6. 1251-1500 m ²	203	223	233	253	268
7. 1501-1750 m ²	203	203	228	228	243
8. 1751-2000 m ²	203	203	203	223	228

DEKLARATË

**PËR PËRBËRJEN FAMILJARE DHE TË ARDHURAT QË REALIZON PËR EFEKT TË
LLOGARITJES SË MBËSHTETJES FINANCIARE TË PUNONJËSVE TË
NDËRMARRJEVE BUJQËSORE QË PRIVATIZOHEN**

Deklaroj nën përgjegjësinë personale se familja ime në datë_____ përbëhet nga këta persona dhe ka këto të ardhura:

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Lidhja me K/famij ljar	Datëlin dja, dita muaji,v iti	Qendra e punës ku punon	Punësu ar në sektor privat ose i vetpun ësuar	Data kur ka marrë tokë në pronësi ose përdorim	Të ardhurat mujore (rrogë,pe nsion, asistencë)	Kompe nsime	Gjithsej
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.
- 6.

1. Të ardhurat gjithsej (kolona 8)
2. Numri i frymëve
3. Mesatarja e të ardhurave për frymë (1:2)

Deklaruesië

Drejtori NB

Komuna ose bashkia

/ /

Vula

Fshati

Qyteti

_____, më _____ 1992

Personi i ngarkuar për llogaritjen
e mbështetjes financiare

Emri, mbiemri

Shënim:

1. Çdo ish-punonjës i NB-së që privatozohet paraqet në komunë ose bashki deklaratën për të përfituar mbështetjen financiare.
 2. Plotësohet nga vetë deklaruesi për të gjithë përbërjen e familjes, e cila të jetë e njëjtë me regjistrimin në gjendjen civile për kolonat b, 1, 2.
 3. Në kolonën 3, për personat e tjerë në ngarkim të shënohet për të papunët "i papunë" ose shkolla ku mëson, studion, reparti ku kryen shërbimin ushtarak, ku e merr përkrahjen sociale, pensionin, refugjat etj.
 4. Deklaruesi në kolonat 4 e 5 shënon "po" ose "jo".
 5. Kolona 6 plotësohet nga deklaruesi së bashku me personin e ngarkuar nga NB-ja dhe personin e ngarkuar në komunë ose bashki.
 6. Për çdo ndryshim në përmbajtjen e deklaruesit të njoftohet brenda 15 ditëve.
 7. Në të gjitha rastet për shumat e marra padrejtësisht deklaruesi detyrohet të kthejë 20-fishin e kompensimeve të përfituara padrejtësisht, pavarësisht nga ndjekja penale që mund t'i bëhet.
- Urdhëri i lëshuar nga kryetari i komunës ose bashkisë është titull ekzekutiv.